

VENDIM
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
ENGINEERING DESIGN PROTOTYPE SHPK

Nr. Vendimi: 04/2021

Data/Ora e mbledhjes: 30.06.2021 / 13:30

Sot, datë 30 Qershor 2021, , në selinë e shoqërisë në Rezidencën Imperial, Lagjja Pavaresia, Bulevardi Ismail Qemali, Palati Anakonda, Kulla 1, Kati 2, Dyqani 32, Vlore u mbajt mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë ENGINEERING DESIGN PROTOTYPE shpk, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, në datën 7 Shkurt 2020 dhe e regjistruar me numër unik M06410202A, për të diskutuar këtë rend dite:

Cështjet e rendit të ditës:

1. Miratimin e pasqyrave financiare për periudhën e mbyllur në datë 31 Dhjetor 2020.
2. Mbulimin e humbjes së paraqitur në pasqyrat paraardhëse.
3. Të tjera (propozime nga Ortakët/nëse ka).

Pjesëmarrës në mbledhje është znj. Maria Fejazaj, ortak i vetëm, zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit, e cila është njëkohësisht edhe administratorja e subjektit. I pranishëm në mbledhje, pa të drejtë vote, është dhe z. Andi Haxhillari, mbajtës i letërnjoftimit Nr. I411281131, i cili është caktuar të mbajë procesverbalin e mbledhjes.


Meqenëse kuorumi i nevojshëm plotësohet, mbledhja u deklarua e mbajtur rregullisht për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës të përmendur më sipër. Pasi shqyrtoi të gjitha çështjet, në përputhje me parashikimet e Nenit 81, të ligjit Nr. 9 901, datë 14.4.2008 *Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare* dhe nenit 18 dhe 27 të *Statutit të shoqërisë*, dhe nenit 33, 33/1 dhe 38 të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 *Për tatimin mbi të ardhurat*, i ndryshuar, Asambleja e ortakëve

VENDOSI:

1. Të miratojë pasqyrat financiare (të ndryshuara) për periudhën që mbyllet në datën 31 Dhjetor 2020.
2. Të miratojë fitimin e paraqitur në këto pasqyra financiare, në shumën 1,632,839 Lekë.
3. Ngarkohet Sekretari i Mbledhjes, Andi Haxhillari, me numër identifikimi I411281131, të bëjë depozitimin e këtij Vendimi ne QKB dhe në Organet tatimore.

Meqenëse nuk ka më çështje për tu diskutuar, mbledhja mbyllet. Ky vendim u mbajt në dy kopje identike dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Ortak i shoqërisë
Maria Fejazaj




Andi Haxhillari
Sekretar i Mbledhjes

